

1. HYRJE

Ky dokument është përgatitur si një shtojcë e Vleresimit të thellë të Ndikimit në Mjedis të impiantit prodhues me cikël të kombinuar në Vlorë, përgatitur nga MWH dhe paraqitur më 6 Tetor 2003. Informacioni i kësaj shtojcë ka për qëllim t'i paraqesë Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës, Bankës Botërore, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankës Evropiane të Investimeve shpjegime të tjera plotësuese të Vleresimit të thellë të Ndikimit në Mjedis. Kjo shtojcë duhet të lexohet plotësisht dhe në lidhje me Vleresimin të thellë të Ndikimit në Mjedis, si pjesën kryesore ashtu edhe atë përmbledhëse. Duhet theksuar se versioni zyrtar me të dhënat e lartpërmendura është kopje e shkruar dhe informacionet që ai përmban nuk janë të disponueshme në formë elektronike.

Shumë nga vërejtjet e bëra për Vleresimin të thellë të Ndikimit në Mjedis kanë të bëjnë me domosdoshmerinë e mbledhjes së të dhënave bazë për vendin e zgjedhur, që nuk ishte e përfshirë në synimet fillestare të studimit. Gjithsesi, donatorët i kanë mundësuar KESH-it mbledhjen e këtyre të dhënave dhe me pas rikonfirmimin e rezultateve të Vleresimit të thellë të Ndikimit në Mjedis. Ky informacion, i cili theksohet në Vleresimin të thellë të Ndikimit në Mjedis, përmbledh:

- Nivelin e merkurit në sedimentet bregdetare
- Cilesinë e ajrit
- Të dhënat meteorologjike të vendit të zgjedhur
- Të dhënat për kullat e ftohjes dhe vendndodhjen e shkarkimeve
- Të dhëna për nivelin bazë të zhurmave
- Të dhëna për monitorimin e përhapjes së fushës elektromagnetike

Mbledhja dhe analizimi i këtyre të dhënave do të përfshihen në planin dhe studimet që rekomandohen në Vleresimin të thellë të Ndikimit në Mjedis. Lista e këtyre planeve dhe studimeve jepet në Seksionin 7.5 të këtij dokumenti.

Në përshkrimin që pas mbledhjes dhe analizimit të këtyre të dhënave, konkluzionet e Vleresimit të thellë të Ndikimit në Mjedis nuk do të ndryshojnë.

Vleresimi i thellë i Ndikimit në Mjedis jep një përmbledhje të kushteve bazë të zonës ku do të zhvillohet projekti. Gjithashtu, mbi këto baze përshkruhen ndikimet e mundshme në mjedis të këtij projekti. Kapaciteti i instaluar i projektit do të varet nga paisjet që do të ofrohen gjatë procesit të tenderit, por do të jetë i shkallës 90-120 MW. Megjithatë, të gjitha analizat e kryera për Vleresimit të thellë të Ndikimit në Mjedis janë kryer duke marrë për bazë kapacitetin më të madh të mundshëm. Në fund, ai jep masat zbutëse që duhen ndërmarre në ndihmë të parandalimit ose zvogelimit të ndikimeve mjedisore dhe sociale të

projektit. Siç shihet ne Seksionin 8 te Vleresimit perfundimtar te Ndikimit ne Mjedis, marrja e ketyre masave zbutese eshte pergjegjesi e EPC kontraktorit dhe/ose e KESH. Gjithashtu Seksioni 8 i Vleresimit perfundimtar te Ndikimit ne Mjedis nenvizon kostot e ketyre masave zbutese. Kjo kosto per fazen e ndertimit eshte e perfshire ne kostot e pergjithshme te projektit, ndersa sa i takojne fazes se funksionimit jane perfshire ne vleresimin e koston se regjimit normal te punes dhe mirembajtjes se tij. Si pjese e masave zbutese, Projekti do te perdore teknologjine me te mire dhe do te jete i pajisur me te gjitha mjetet qe kerkohen per kontrollin mjedisor.

Keto paisje, te cilat do te jene te specifikuara ne dokumentet e tenderit, perfshijne:

- Injeksionin me uje per te kontrolluar shkarkimet e oksideve te karbonit
- Ndaresit uje/lende djegese
- Vendi mbajtes per depozitat e lendes djegese
- Impianti i trajtimit te ujrave te ndotur te objektit
- Difuzor shkarkimi
- Paisjet e nevojshme per rrjedhjet, perfshire nje varke te vogel, depozita me galixhand e lendes djegese dhe lende kimike qe kane vetine e shperhapjes se naftes
- Monitorimi i klorit residual
- Lartesia e oxhakut sipas standarteve GEP
- Lende djegese e distiluar me permbajtje te ulet sqfuri
- Izolues (rrethim) akustik
- Tubacion me filtra per rrjedhjen e ngadalshme te ujit

Me nje shkrese te dates 17 Tetor 2003, drejtuar Bankes Boterore, Ministria e Ekonomise se Shqiperise, Ministria e Industrise dhe Energjitikes dhe Ministria e Mjedisit kane rene dakort per zbatimin e te gjitha rekomandimeve te paraqitura ne Vleresimin perfundimtar te Ndikimit ne Mjedis.

2. PERMBLEDHJE E VLRESIMIT PERFUNDIMTAR TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Nje nder verejtjet ka te beje me perfshirjen e nje gjuhe te dyte ne permbledhesen e Vleresimit perfundimtar te Ndikimit ne Mjedis. Kjo gjuhe e dyte gjendet ne kapitujt (seksionet) "Plani i Monitorimit" dhe "Diskutimet me Publikun". Megjithate, per te krijuar lidhjen me permbledhesen e Vleresimit perfundimtar te Ndikimit ne Mjedis, ketu eshte rishtypur nje pjese e saj me shtesat e kapitujve te lartpermendur.

2.1 TE PERGJITHSHME

Sektori i energjise elektrike ne Shqiperi administrohet nga KESH, nje kompani e integruar vertikalisht me kapitale te prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes. KESH eshte gjithashtu pergjegjes per shitjen e energjise dhe shkembimin e saj me disa nga vendet fqinje. KESH perfaqeson nje monopol dhe per qellime praktike eshte kompania e vetme e sektorit elektroenergjitik shqiptar.

Aktualisht, sektori elektroenergjitik shqiptar po perballet me shume probleme. Energjia elektrike e perftuar nga shfrytezimi i ujrave ze mbi 98% te prodhimit vendas. Sipas Planit Strategjik te Veprimit, date 28 Shkurt 2001, pergatitur nga Njesia Operative per Reformen e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar, KESH po perballet me kushte jonormale te thatesires duke qene i detyruar te nderprese furnizimin me energji elektrike te konsumatoreve ne disa zona nga 10 deri ne 12 ore ne dite.

Konsumi ditor i energjise elektrike per periudhen e dimrit kap vleren e 22 milione kwh. Ne kushte normale te motit prodhimi vendas arrin nga 7 deri 13 milione kwh ne dite, ndersa prodhimi i termocentraleve eshte 1.2 milion kwh ne dite. Duke qene se prodhimi ne vend i energjise elektrike nuk eshte i barabarte me kerkesen, Shqiperia eshte e detyruar te importoje energji elektrike.

Siç shihet Shqiperia ka mangesi te konsiderueshme ne furnizimin e sigurte dhe te besueshem me energji elektrike. Per kete arsye dhe per te siguruar nje furnizim te besueshem me energji elektrike gjate gjithë vitit, Njesia Operative i ka rekomanduar Parlamentit zbatimin e nje politike energjitike qe te perfshije ndertimin e impianteve te rinj prodhues duke marre ne konsiderate koston e ulet dhe lendet e ndryshme djegese. Per rrjedhoje, Ministria e Industrise dhe Energjitikes dhe KESH kane filluar studimet per mundesite teknike dhe financiare te ndertimit te termocentraleve te rinj per prodhimin e energjise elektrike ne Shqiperi.

Nje grup firmash europiane, ne te cilin perfshihen Deutsche Energie Consult Ingenieurgesellschaft (DECON), Electricité de France (EDF) dhe LDK Consultants, kane hartuar nje plan te shtrirjes se prodhimit te energjise elektrike ne vend. Sipas ketij plani, rezervat e energjise elektrike ne Shqiperi do te vazhdojne te behen me te ceneshme nga mungesa e termocentraleve te rinj per shkak te varesise se theksuar nga kushtet hidrometereologjike, mungesa e reshjeve dhe pasiguria e importit. Ky raport thekson nevojën e pershpejtimit si te hartimit te projektit te detajuar ashtu dhe planifikimit te metejshe me te tij per rritjen e prodhimit te energjise elektrike me ane te termocentraleve. Ndertimi i termocentraleve ne Shqiperi eshte nje perçapje e kujdesshme ne drejtim te menjanimit te varesise se theksuar nga burimet jo te sigurta hidrike te prodhimit dhe importi i energjise elektrike.

Agjensia e Zhvillimit dhe Tregtise se Shteteve te Bashkuara te Amerikes i dha qeverise shqiptare nje grant si ndihme per ndertimin e nje termocentrali te ri. Ne vijim, Ministria e Industrise dhe Energjitikes caktoi firmen Montgomeri Watson Harza (MWH) per zgjidhjen e tre detyrave. Se pari, vleresimin dhe zgjedhjen e vendit me te pershtatshem per ndertimin e nje termocentrali te ri, teknologjise dhe lendes djegese te nevojshme. Se dyti, studimin e fizibilitetit te zones se perzgjedhur per te vleresuar si kerkesat teknike ashtu edhe mundesite ekonomike dhe mjedisore. Dhe se fundi, kryerjen e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis te termocentralit te propozuar. Kjo pune nisi ne vitin 2001.

Sa lidhet me detyren e pare, MWH vleresoi 7 zona te konsideruara si te mundshme, konkretisht, Durres, Elbasan, Korçe, Fier dhe 2 vende ne Vlore, Vlora A dhe B. Vleresimi u krye permes nje metode automatike qe i renditi zonat e studiuara mbi bazen e disa kriterëve, nder te tjera rezervat me lende djegese, rezervat ujore, mundesite e transmetimit, kosto dhe ndikimet ne mjedis. Nje raport paraprak me rezultatet e ketij vleresimi u paraqit me date 6 Qershor 2002, i cili rekomandoi zonen Vlora B, e cila ne vijim do te cilesohet thjesht zona Vlore, llojin e lendes djeges, ngarkesen baze dhe teknologjine me te mire te prodhimit, ate me cikël te kombinuar. Per me teper raporti nuk evidenton asnje te mete fillestare sa i takon furnizimit me lende djegese, furnizimit me uje, mundesive per transmetim dhe nga pikpamja mjedisore. Ne Qershor 2002 Ministria e Industrise dhe Energjitikes dhe KESH rane dakort me rekomandimet e MWH dhe e autorizuan ate te vazhdonte me detyren e dyte.

Bazuar ne te dhenat per vendin, teknologjine dhe lenden djegese te percaktuar ne raportin e paraqitur, MWH kreu nje studim fizibiliteti te detajuar per vleresimin si te kerkesave teknike ashtu edhe mundesive ekonomike, sociale e mjedisore per ndertimin e TEC-it ne zonen e perzgjedhur. Konkretisht, MWH

- Percaktoi kerkesat teknike per termocentralin e propozuar
- Vleresoi koston financiare
- Kreu analizat ekonomike e financiare
- Kreu analiza paraprake te ndikimeve ne mjedis

Studimi i fizibilitetit u perqendrua ne ngritjen e nje impianti me kapacitet te instaluar nga 90 ne 130 MW. Ky studim perforcoi rekomandimet e bera ne studimin e pare te vendit, si me poshte:

- Vlora eshte zona me e pershtatshme per ndertimin e nje termocentrali te ri
- Teknologjia e ciklit te kombinuar eshte me e mire se ajo e turbinave me avull te krijuar nga djegia e qymyrit

- Nje impiant prodhues me cikel te kombinuar qe do te punoje me nafte te distiluar eshte me i pershtatshem ne pikpamje teknike, mjedisore, ekonomike dhe financiare.
- Ne krahasim me zonat e tjera, Vlora ka koston me te ulet te prodhimit

Studimi perfundoi ne Tetor te vitit 2002 dhe pas aprovimit nga KESH, MWH u autorizua te vazhdoje me detyren e trete, Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis.

Ne anen tjeter, studimi i DECON-EDF-LDK mbi planin e shtrirjes se prodhimit te energjise elektrike, ne menyre te pavarur konfirmoi rezultatet e arritura nga MWH se, ngritja e nje termocentrali ne Vlore, me cikel te kombinuar duke perdorur nafte te distiluar, eshte mundesia me e mire per nje burim te ri prodhimi te energjise elektrike ne Shqiperi.

2.2 PROCESI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS (VNM)

2.2.1 Kerkesat e VNM

Eshte parashikuar qe TEC-i i Vlores do te kreditohet nga Banka Boterore, Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim dhe Banka Europiane e Investimeve. Secili nga institucionet financues ka politikat dhe procedurat e veta specifike sa i takon nxitjes se mbrojtjes se mbjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem. Keto procedura perfshijne nje proces studimi te detajuar te mjedisit dhe pergatitjen e Vleresimit perfundimtar te Ndikimit ne Mjedis, perpara se te aprovohet financimi i projektit. Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis per TEC-in e propozuar te Vlores eshte kryer ne perputhje me kerkesat e te tre ketyre institucioneve financuese si dhe me standartet e Bashkimit European. Per lehtesi, standartet me tej do te quhen standarte nderkombetare.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis jep nje permbledhje te te gjitha informacionit te mundshem per kushtet fillestare te zones, perfshire kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe kushtet social-ekonomike. Keto kushte si dhe standartet e normat e aplikueshme jane mbajtur parasysh gjate procesit te kryerjes se VNM per te vleresuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale te TEC-it te propozuar.

Procesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis perfshin ndikimet e mundshme ne ajer, toke, burimet ujore dhe kushtet sociale e kulturore gjate fazave te ndertimit dhe funksionimit te TEC-it si dhe infrastrukturen shtese per transmetimin. Vleresimi i kushteve sociale e kulturore perfshin punesimin, perdorimin e tokes, burimet e lendes se pare, peshkimin, lundrimin detar, transportin dhe sherbimet per komunitetin lokal.

Ne Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis gjithashtu jepen te gjitha masat zbutese qe duhen ndermarre per parandalimin ose zvogelimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale te ketij projekti. Keto masa jane te perfshira ne nje Plan te Menaxhimit te Mjedisit (PMM), i cili eshte i detajuar ne raport. Plani i Menaxhimit te Mjedisit konsiston ne marrjen e nje sere masash zbutese, monitoruese dhe institucionale gjate ndertimit dhe funksionit te TEC-it te propozuar per eleminimin, kompesimin apo zvogelimin e ndikimeve te ndryshme mjedisore dhe sociale. Gjithashtu, ne plan perfshihen te gjitha veprimet e nevojshme per venien ne zbatim te ketyre masave. Me tej, Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis jep ne vija te pergjithshme plane te monitorimit dhe menaxhimit specifik te mjedisit dhe identifikon te gjitha kerkesat dhe grafiket e nevojshem.

2.2.2 Pershkrimi i projektit

Me poshte jepet nje pamje e pergjithshme e veçorive kryesore te TEC-it te planifikuar te Vlores qe kane lidhje me Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis.

Pershkrimi i vendit

Vendi i perzgjedhur ne Vlore eshte nje siperfaqe e gjelber prej 6 hektarësh, ne afersi te terminalit te depozitave te naftes ne detin Adriatik, ne veri te Portit te Vlores. Ndodhet rreth 6 km larg Portit te Vlores, ne nje zone bregdetare te shkrete, me pak bimesi ose kafshe te egra.

Ne zonen e Vlores nuk ka burime te medha te shkarkimeve ne ajer me pasoje ndotjen. Disa fabrika e uzina qe ekzistonin ne te kaluaren, pushuan se funksionuari pas vitit 1990. Ne ana tjeter, mungojne te dhenat e sakta mbi cilesine e ajrit ne kete zone. Per shkak te mungese se aktivitetit industrial dhe te dhenave te sakta mbi cilesine e ajrit, eshte pranuar qe te dhenat e tanishme mbi cilesine e ajrit ne zonen e Vlores, jane te kenaqshme sipas kritereve te Bankes Boterore. Qeveria Shqiptare duhet te filloje sa me shpejt (brenda 12 muajve) mbledhjen e te dhenave specifike per cilesine e ajrit ne kete zone. Sapo te jene ne dispozicion te dhenat e mjaftueshme, do te kryhen modelime ajri shtese per te vertetuar rezultatet e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis dhe per te rekomanduar masa te metejshme lehtesuese, nese eshte e nevojshme, gjate fazes se zbatimit te projektit.

Teknologjia e TEC-it

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis eshte bere per nje cikël te kombinuar prej dy turbinash me djegie dhe nje turbine me avull (2 ne 1).

Nga djegia e naftes se distiluar ne nje turbine me djegie shkarkohen ne ajer dioksiod squfuri (SO₂), okside te azotit (NO_x), monoksid karboni (CO), lende e grimcuar e shkalles me te vogel se 10 micron (PM₁₀), dioksid karboni (CO₂) dhe substanca organike te avullueshme (VOC). Modelimi kompjuterik i ndikimit ne ajer te shkarkimeve te SO₂, NO_x, PM₁₀ dhe CO pershkruhen me poshte ne kete permbledhje. Sa i takon CO₂ dhe substancave organike te avullueshme, per to nuk ka standarte te vendosura e per rrjedhoje keta ndotes nuk jane modeluar. Lenda e grimcuar mund te permbaje gjurme te metaleve te renda te cilat çlirohen ne atmosfere gjithashtu si ndotesa, por sasia e tyre eshte kaq e paperfillshme sa as ato nuk jane modeluar.

Per permbushjen e standarteve qe aplikohen per cilesine e ajrit dhe per te kontrolluar shkarkimet, ne TEC do te perdoret teknologjia me e mire e mundur per kete qellim. Ne turbinat me djegie do te perdoret kontrolli i djegies sa me te mire dhe teknologjia e injektimit te ujit per te kontrolluar shkarkimin e NO_x. Veg kesaj, kontrolli i djegies ne keto turbina do te sherbeje edhe per minimizimin e produkteve nga mosdjegia e plote dhe zvogelimin e shkarkimeve te CO, PM₁₀ dhe VOC. Ulja e permbajtjes se sqfurit ne lenden djegese do te kontrolloje shkarkimin e SO₂.

Ne tabelen A.1 jane dhene standartet nderkombetare per shkarkimet ne ajer nga TEC-et dhe vleresimi i shkarkimeve per TEC-in e planifikuar te Vlores. Nje model kompjuterik, i cili pershkruhet me tej ne kete seksion si dhe ne pjesen kryesore te ketij raporti, perdor kete shkalle shkarkimesh per te parashikuar ndotjen e ajrit ne kete zone nga TEC-i i parashikuar. Siç mund te shihet, sipas vleresimeve, shkarkimet nga TEC-i Vlores jane me te ulta e per rrjedhoje me te mira se standartet nderkombetare. P.sh, shkarkimi i vleresuar i PM₁₀ nga TEC-i Vlores eshte 3 tre here me i mire se standartet nderkombetare, shkarkimet e vleresuara te NO_x perafersisht 40% me te mira se standartet dhe shkarkimi i vleresuar i SO₂ disa qindra here me i mire se standartet.

TABELA A.1 (rishikim i Tabeles 1.1 nga VNM perfundimtar)

Standartet e shkarkimeve ne ajer

Ndotsi	Shkarkimet standarte nga TEC-et		Shkerkimet e vleresuara per TEC-in Vlore
	Sipas bankes Boterore ^a	Sipas Bashkimit European ^b	
PM ₁₀	50 mg/Nm ₃	50 mg/Nm ₃ (i thate@3%O ₂)	14 mg/Nm ₃
NO _x	165 mg/Nm ₃ (i thate@15%O ₂)	450 mg/Nm ₃ (i thate@3%O ₂)	97 mg/Nm ₃
SO ₂ ^c	0.20 TPD/ME 2,000 mg/Nm ₃ (i thate@3%O ₂)	1,700 mg/Nm ₃ (i thate@3%O ₂)	0.0048 TPD/ME 57.4 mg/Nm ₃

^a Manual i Bankes Boterore per parandalimin dhe zvogelimin e ndotjes. Udhezues per termocentralet e rinj – Korrik 1998

^b Direktiva 2001/80/EC e Parlamentit Europian dhe Keshilli te Europes, e dates 23 Tetor 2001, per kufizimin e shkarkimit ne ajer te disa lloj ndotesish nga impiantet e medhenj me turbina djegese. Nese kapaciteti i pergjithshem kalon 300 MW atehere ne varesi te madhesis se impiantit, niveli i SO₂ eshte me i ulet (i kufizuar).

^c Norma e shkarkimit te SO₂ per lende djegese me permbajtje 0.1% te sqfurit, e cila perputhet me Direktiven 1999/32/EC, artikulli 4.

Zhurma

Zhurmat qe do te emetohen gjate faze se operimit te TEC-it do te jene sipas standarteve nderkombetare, 70dB per zonat tregtare dhe industriale. Turbinat djegese duhet te jene te mbyllura me nje rrethim akustik qe nuk do te lejoje nivele te zhurmes mbi 85 dB(A).

Furnizimi me lende djegese

Ne kufirin verior te vendit ku do te ndertohet TEC-i ndodhet nje terminal i depozitave te lendes djegese dhe tubacioni perkates. TEC-i i ri do te shfrytetoje per furnizimin me lende djegese tubacionet ekzistues te terminalit qe ndodhet prane Nartes.

Ndikimet e mundshme ne mjedis nga ruajtja dhe transportimi i lendes djegese te distiluar do te zvogelohen permes shfrytezimit te praktikave me te mira menaxhuese, praktika qe ndjekin ndermarrje publike dhe private per te perfshire parandalimin e ndotjeve ne veprimtarite e tyre. Per normalizimin e situates nga rrjedhjet e papritura te lendes djegese do te kete nje plan te caktuar si dhe te gjitha paisjet e nevojshme. Pergatitja e ketij plani dhe sigurimi i paisjeve te nevojshme perkatese gjate fazes se ndertimit te TEC-it jane pergjegjesi e KESH. Parashikohen me shume se 30 cikle furnizimi ne vit. Kapaciteti i anijes qe do te perdoret per furnizim duhet te jete minimumi 3,260 m³. Ne planin e veprimeve duhet te perfshihet monitorimi dhe levizja e anijes ne kushte te renduara te motit dhe ne kontraten e furnizimit duhet te parashikohet zbatimi i ketyre masave. Brenda mjediseve te TEC-it duhet te ndertohet nje mbajtes dytesor i depozitave te lendes djegese.

Transmetimi

Lidhja me rrjetin e transmetimit do te realizohet me nje linje 7 km, nga vendi ku do te ndertohet TEC-i deri ne nenstacionin e Babices. Linja transmetuese nuk do te kete ndikim ne mjedis. Gjeresia e duhur per nje linje transmetimi 230kV eshte ndermjet 40m dhe 60m. Per te zvogeluar ndikimet ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe funksionimit do te pastrohen vendet ku linja nderthuret me bimesine. Pas perfundimit mjedisi perreth do te mbillet me bimet karakteristike te rajonit.

Uji

Ftohja do te realizohet me ujin e detit. Tubacioni nenujor dhe difuzoret e shkarkimit jane parashikuar te vendosen ne nje distance afersisht 600 m larg bregut te detit. Ndikimet ne mjedisin detar gjate fazes se ndertimit te tubacionit dhe shkarkuesit do te zvogelohen permes percaktimit sa me te sakte te vendndodhjes se tyre. Mbetjet nga ndertimi nuk do te hidhen ne gji.

Ndikimet e mundshme ne mjedisin detar do te zvogelohen duke llogaritur saktesisht kapacitetin e tubacionit. Ne çdo 25 cm distance te tij do te vendosen skara hekuri. Se fundi pompa thithese e ujit per ftohje do te jete e pajisur me filter. Per te zvogeluar futjen e mikroorganizmave detare ne brendesi te tubacionit, shpejtesia e rrjedhjes se ujit ne te do te jete me pak se 1 m/s.

Ndikimet e mundshme ne mjedisin detar nga shkarkimi i ujit te perdorur per ftohje, perfshijne:

- Ndryshimin e regjimit te temperatures se ujit e ndoshta te sedimentimit ne mjedisin prites;
- Tjetersimi i menyres se jeteses deri ne zhdukje i organizmave detare per shkak te ndryshimit te regjimit te temperatures;
- Nxitja ne shtimin e disa organizmave; Stimulim ne produktivitetin e organizmave;
- Zvogelimi i ngopjes me oksigjen;
- Ndryshime ne perberjen dhe shperberjen e grupeve te organizmave detare, perfshire ato te brigjeve europiane (ne veçanti te grykedherdhjeve);
- Ndryshime te lokalizuara ne shperndarjen e zogjve qe sherbejne si rezerva ushqimore per peshqit ne afersi te shkarkimeve termike.

Modelimi i ndikimeve termike nga shkarkimi i ujit te perdorur per ftohje ne mjedisin detar te gjirit te Vlores eshte paraqitur i detajuar me tej ne kete permbledhje si dhe ne pjesen kryesore te raportit.

Perberja kimike e ujit te perdorur per ftohje ne momentin e shkarkimit nuk eshte marre ne shqyrtim pasi e vetmja substance kimike qe shtohet eshte hipoklorit natriumi, i cili sherben per te parandaluar ndotjen me mikroorganizma te pjeseve te sistemit ftohes. Me fjale te tjera, uji qe do te perdoret per ftohje do te thihet nga deti, do te qarkulloje neper impiant dhe ne fund do te shkarkohet perseri ne det. Perqendrimi i klorit gjate procesit do te jete jo me shume se 0.2 mg/l per te zvogeluar efektin e tij ne pikat e shkarkimit te ujit ftohes. Ky nivel i pergjigjet standarteve te Bankes Boterore, siç percaktohen ne Udhezuesin per Parandalimin dhe Zvogelimin e Ndotjes nga TEC-et. Praktikisht, vlera e klorit rezidual eshte me pak se 0.2 mg/l.

2.2.3 Modelimi i ndikimeve

Me poshte jepet modelimi i ndikimit ne cilesine e ajrit urban te shkarkimeve te gazrave nga impianti prodhues dhe modelimi i ndikimit termik te mjedisit detar nga shkarkimi i ujit ftohes.

Modelimi i ndikimit ne cilesine e ajrit

Standartet nderkombetare te cilesise se ajrit ne mbrojtje te shendetit te njerezve dhe mjedisit per monoksidin e karbonit (CO), oksidet e azotit (NO_x), dioksidin e sqfurit (SO₂) dhe lenden e grimcuar (PM₁₀) jepen ne Tabelen 1.2. Modeli kompjuterik eshte perdorur per te parashikuar perqendrimin ne dalje te shkarkimeve te impiantit prodhues dhe se si ndikimet ne mjedis te TEC-it te planifikuar do t'i pergjigjen standarteve nderkombetare.

Per te analizuar dhe vleresuar perqendrimin me te larte te mundshem te CO, NO₂, PM₁₀ dhe SO₂ ne nivelin zero eshte perdorur modeli ISCST3 i Agjensise Amerikane te Mbrojtjes se Mjedisit, i cili eshte nje program kompjuterik nderkombetar per modelimin e ajrit. Ky model eshte vleresuar si i pershtatshem per zona bregdetare siç eshte rasti i zones se Vlores. Ne Tabelen 1.2 jepen rezultatet e modelimit dhe standartet nderkombetare. Siç mund te shihet, rezultatet e modelimit jane mjaft me te ulta e per rrjedhoje me te mira se standartet nderkombetare, duke provuar keshtu se shkarkimet ne ajer te TEC-it do te kene ndikime shume te vogla ne cilesine e ajrit dhe ndikime te paperfillshme ne shendetin e njerezve.

Me tej, rezultatet e modelimit tregojne vlera me te ulta e per rrjedhoje me te mira se limitet e percaktuar te perqendrimit te acidit per mbrojtjen e bimesise dhe ekosistemeve. Bazuar ne keto rezultate, TEC-i do te kete ndikime te paperfillshme ne floren dhe faunen e zones. Shkarkimet e acidit nga TEC-i nuk do te kene efekte te konsiderueshme ne burimet natyrore.

Tabela A.2 (rishikim i Tabeles 1.2 te VNM perfundimtar)

Standartet e Bankes Boterore dhe te Bashkimit European per cilesine e ajrit krahasuar me rezultatet e modelimit per ndikimin e shkarkimeve ne ajer nga TEC-i propozuar i Vlores

Ndotsi	Mesatarja vjetore			Mesatarja per 24 ore			Mesatarja per 8 ore			Mesatarja per 1 ore		
	Ndikimi maksimal sipas modelimit ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	Standartet per cilesine e ajrit		Ndikimi maksimal sipas modelimit ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	Standartet per cilesine e ajrit		Ndikimi maksimal sipas modelimit ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	Standartet per cilesine e ajrit		Ndikimi maksimal sipas modelimit ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	Standartet per cilesine e ajrit	
		Banka Boterore ^a	Bashkimi European ^b		Banka Boterore ^a	Bashkimi European ^b		Banka Boterore ^a	Bashkimi European ^b		Banka Boterore ^a	Bashkimi European ^b
CO							40.9		10,000			
NO _x	3.1	100	30 ^c , 40	16.2	150					89.3		200
PM ₁₀	0.3	50	40	1.8	150	50						
SO ₂ ^e	1.9	80	20 ^d	9.7	150	125				53.4		350

□ = jo te zbatueshme

^a Manual i Bankes Boterore per parandalimin dhe zvogelimin e ndotjes. Udhzues per termocentralet e rinj – Korrik 1998

^b Vlerat limit te zbatueshme qe nga 1 Janar 2005. Keto vlera limit perfaqesojne maksimumin e lejuar edhe ne raste te tejkalimit

^c Limiti qe siguron mbrojtjen e bimesise

^d Limiti qe siguron mbrojtjen e ekosistemeve

Mjedisi detar

Modelimi u perdor per te vleresuar edhe ndikimet termike te TEC-it, me konkretisht rritjen e mundshme te temperatures se ujit te detit pas shkarkimit te ujit te perdorur per ftohje dhe tregoi se ai eshte brenda normave nderkombetare te lejuara, qe jane jo me shume se 3°C. Uji qe eshte perdorur per ftohje pas derdhjes ne gjirin e Vlores do te rrise temperaturen vetem rreth vendit te shkarkimit.

Per modelimin e ndikimeve termike u perdor modeli CORMIX i Agjensise Amerike te Mbrojtjes se Mjedisit dhe Universitetit Cornell. Ky model, i pranuar boterisht si menyre analize per pikat e shkarkimit, eshte i vlefshem te perdoret me te dhena laboratorike dhe te terrenit ne mjediset bregdetare. Standartet e industrise ne lidhje me shkarkimet termike pergjithesisht caktojne nje zone specifike perzierje per asimilimin fillestar te procesit te shkarkimit te ujit. Per te parashikuar rritjen e temperatures si pasoje e shkarkimit te ujit ftohes ne modelim eshte perdorur nje zone A 23m. Kjo vlere eshte brenda zones se perzierjes prej 100m, rekomanduar ne Udhezuesin e Bankes Boterore per Parandalimin dhe Zvogelimin e Ndotjes nga TEC-et.

Rasti me i keq i ndikimeve termike ne plan veprimin e modeluar eshte vleresuar ne perputhje me barazpeshen e ujit ne impiant. Menyra e veprimit per rastin me te keq eshte perzgjedhur per kushte te funksionimit me diference te madhe te temperatures se ujit qe rrjedh dhe asaj te ujit te vete detit Adriatik. Sipas modelimit, tubacioni shkarkues perfaqesohet nga nje difuzor me shume dalje automatike, me shtrirje 600 m nga bregu, kend 45 grade nga bregu (kend horizontal) dhe 0.15 m nga fundi i oqeanit.

Rezultate e modelimit tregojne nje rritje te temperatures prej 0.87°C ne periferi te zones mikse. Kjo vlere eshte 60% me e ulet, per rrjedhoje me e mire, se standartet nderkombetare me rritje te temperatures jo me shume se 3°C.

2.2.4 Kerkesat sociale

Duke patur parasysh kushtet e sotme sociale dhe ekonomike te zones se Vlores, ky rajon do te kete perfitime te medha. Nuk parashikohet qe ndertimi i TEC-it te shkaktojte fluks ne ardhjen e njerezve nga zonat e tjera dhe per pasoje infrastruktura e zones se Vlores do te ndikohet fare pak.

Gjate periudhes tetembedhjete mujore te ndertimit te TEC-it do te jene te nevojshem rreth 500 punetore. Pjesa me e madhe e fuqise punetore ne zonen e Vlores ka perfunduar studimet e mesme. Sistemi shkollor perfshin 19 shkolla 8-vjecare, 3 shkolla te mesme te pergjithshme, nje shkolle te mesme tregtare, nje shkolle te mesme industriale dhe nje shkolle te mesme artistike. Gjithashtu ne

Vlore gjendet edhe Universiteti Politeknik. Universiteti leshon diploma ne inxhinieri dhe dege te tjera me pak teknike. Infrastruktura e mesimdhenies ne kete zone eshte e qendrueshme prandaj ekzistenca si e TEC-it ashtu edhe ketyre institucioneve mund te kete perfitime te dyaneshme.

Edhe ndonje ndikim negativ i mundshem do te nenvleftesohet prej ndikimeve pozitive te tij. TEC-i do te ngrihet ne pjesen industriale te Vlores dhe do t'i sherbeje zhvillimit te pergjithshem social dhe ekonomik te ketij qyteti.

2.3 PLANI MONITORUES

Vleresimi perfundimtar i Ndikimit ne Mjedis perfshin edhe nje Plan te detajuar te Monitorimit te Mjedisit. Ky plan i monitorimit do te sherbeje si per te provuar se ndikimet e mundshme jane parashikuar drejt, ashtu edhe per gjetjen ne nje faze sa me te shpejte te atyre te paparashikuara. Kjo do te beje te mundur marrjen dhe zbatimin e masave te nevojshme perpara se demi te jete i pariparueshem. Ne VNM perfundimtar perfshihen plane monitorimi per secilin aspekt mjedisor si ne fazen e ndertimit ashtu dhe ate te funksionimit te TEC-it. Ne Planin e Monitorimit te Mjedisit percaktohet edhe pala pergjegjese per çdo veprim monitorues.

2.4 KONSULTIMET ME PUBLIKUN

Ne lidhje me kete projekt, ne qytetin e Vlores jane zhvilluar tre takime me publikun. Takimi i pare eshte zhvilluar ne vjeshte te vitit 2002 me qellim paraqitjen e ketij projekti para publikut vlonjat dhe fillimin e konsultimeve te nevojshme per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Takimi i dyte, i zhvilluar me 2 Prill 2003 shenoi perfshirjen e publikut ne Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Ndersa ne takimin e trete qe u zhvillua ne Vlore me 3 Shtator 2003 u diskutua drafti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis. Ky draft, i dates 23 Korrik 2003, shoqeruar me nje shkrese te Qeverise Shqiptare iu be i njohur publikut me shume se 30 dite para zhvillimit te takimit. Ky proces u realizua nga Agjensia Kombetare e Energjise ne bashkepunim te ngushte me Ministrine e Industrise dhe Energjitikes, KESH sh.a., Ministrine e Mjedisit, Agjensine Rajonale te Mjedisit ne Vlore, Ministrine e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit, projektin e PNUD per lagunen e Nartes, Bashkine e Vlores, Qarkun Vlore, Prefekturen e Vlores, qytetaret e Vlores, studentet e Universitetit te Vlores, mediat kombetare dhe lokale, me shume se 20 organizata joqeveritare dhe subjekte te tjere te interesuar per çeshtjet sociale dhe mjedisore. Ne te gjitha keto takime publiku ka shprehur opinionet e tij per te gjitha çeshtjet themelore te projektit. Gjithashtu publiku ka mundur te shprehe mendimet e tij per çeshtje me specifike. Keto takime jane transmetuar ne edicionet informative te stacioneve televizive

kombetare. Ne Aneksin E te VNM perfundimtar jane pasqyruar shenimet e ketyre takimeve se bashku me listen e pjesemarresve ne to. Takimin e dyte e kane ndjekur me shume se 100 pjesemarres por jo te gjitha kane nenshkruar per prezencen e tyre.

Drafti i VNM u diskutua ne takimin e trete te zhvilluar me 3 Shtator 2003. Gjate ketij takimi, publikut iu bene prezent detaje shtese per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis dhe projektin ne pergjithesi. Pjesemarresve iu dha mundesia te diskutonin per ndikimet e mundshme dhe sugjerimet e tyre u perfshine ne VNM. Takimi u pasqyruar ne menyre te hollesishme nga media lokale. Kopje zyrtare te Draftit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ndodhen ne Ministrine e Mjedisit, Ministrine Rregullimit te Territorit dhe Turizmit, Ministrine e Industrise dhe Energjitikes, KESH dhe Agjensine Kombetare te Energjise. Kjo e fundit dergoi 10 kopje ne gjuhen angleze dhe 20 kopje ne gjuhen shqipe ne Bashkine e Vlores, Qarkun e Vlores dhe Prefekturen e Vlores. Nje kopje anglisht dhe nje shqip ndodhen ne Biblioteken e qytetit te Vlores.

Sa i takon ndikimeve ne mjedis te ketij projekti jane zhvilluar edhe takime te tjere nder te cilet:

- Takimi i perfaqesuesve te Ministrise se Mjedisit me ata te kompanise MWH, ne Tirane me 15 Gusht 2002
- Takimi i perfaqesuesve te Ministrise se Mjedisit me ata te kompanise MWH, ne Tirane me 31 Mars 2003

2.5 KONKLUZIONE

Analizat e nevojshme per te permbushur kerkesat e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis jane kryer sipas standarteve nderkombetare. VNM ka percaktuar kushtet fillestare te zones dhe mbi kete baze ka vleresuar ndikimin e TEC-it te propozuar ne burimet e saj. Ndikimet e mundshme pozitive dhe negative te projektit te propozuar jane identifikuar dhe llogaritur ne kufijte e tyre maksimale. Gjithashtu jane percaktuar masat zbutese qe duhet te merren ne fazat e ndertimit dhe operimit te TEC-it si dhe ndonje ndikim i mbetur negativ.

Ky impiant prodhimi i energjise elektrike eshte nje njesi me cikel te kombinuar dhe shkarkimet ne ajer te tij do te jete ne pershtatje me standartet nderkombetare. Si nje pjese e VNM, u krye modelimi i ndikimit ne cilesine e ajrit urban te zones. Rezultatet e modelimit tregojne se TEC-i do te jete ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise se ajrit. Per me teper, modelimi tregoi se impianti prodhues nuk do te shkaterroje cilesine e ajrit ose mjedisin e zones.

Njekohesisht, modelimi si pjese e VNM u perdor per te vleresuar ndikimin termik nga shkarkimi ne Gjirin e Vlores i ujit te perdorur per ftohje. Modelimi tregon se shkarkimi i ujit te perdorur per ftohje do te shkaktoje nje ngritje te temperatures se ujit te detit me 0.87°C, ndikim ky krejtesisht i pranueshem. Ky nivel i ngritjes se temperatures eshte me i mire se standartet nderkombetare.

Ne perfundim, impianti i planifikuar per prodhimin e energjise elektrike do te jete ne perputhje me te gjitha standartet nderkombetare per mjedisin dhe do te ndikojte pozitivisht ne ekonomine lokale pa shkaktuar ngarkese ne infrastrukture dhe sherbime. Njekohesisht, TEC-i do te lehtesoje shume nga problemet me te cilat po perballet sistemi elektroenergjitik shqiptar.

3. LEGJISLACIONI, AKTET ADMINISTRATIVE DHE POLITIKAT

3.1 PERCAKTIMI NE LIGJ I ZONAVE TE MBROJTURA

Ne Qershor te vitit 2002 Parlamenti Shqiptar aprovoi ligjin per Zonat e Mbrojtura. Qellimi i ketij ligji ishte percaktimi i zonave te mbrojtura per te siguruar ruajtjen e rezervave natyrore, biodiversitetit, natyres dhe llojeve te veçanta. Gjithashtu ky ligj sherben per zbatimin e detyrimeve te caktuara qe rrjedhin nga aderimi i Republikes se Shqiperise ne programe te ndryshme per mbrojtjen e mjedisit.

Ne ligjin per Zonat e Mbrojtura percaktohen gjashte kategori me shkalle te ndryshme mbrojtjeje, si me poshte:

Rezerve strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I): territore te vegjel deri ne 1,000 hektare, me vlera te veçanta natyrore, te formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtesisht te ndryshueshme.

Park kombetar (kategoria II): territore te gjera, zakonisht me te medha se 1,000 hektare, unike sipas standarteve kombetare dhe nderkombetare, te formuara nga ekosisteme natyrore qe nuk jane te prekura nga veprimtaria e njeriut.

Monument natyror (kategoria III): formacion natyror me shtrirje te vogel, i veçante per nga formimi gjeologjik ose nje habitat i rralle me vlere shkencore dhe estetike.

Rezervat natyror i menaxhuar/Zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve (kategoria IV): territore te vegjel, zakonisht deri ne 1000 hektare qe permbajne lloje veçanerisht te mbrojtur te faunes dhe flores, qe jane korridore te rendesishme te migrimin ose perdoren per qellime kerkimore e edukative.

Peizazh i mbrojtur (kategoria V): territore te gjera, zakonisht me te medha se 1,000 hektare, me pizazh te veçante dhe te formuar mire, me ekosisteme te ndryshem detare ose tokesore, me monumente historike.

Zona te mbrojtura per qellime te ndryshme (kategoria VI): (akoma ne proces peraktimi).

Ministria e Mjedisit e Shqiperise eshte autoriteti pergjegjes qe propozon kategorite e ndryshme te mbrojtjes dhe percakton kufijte e zonave qe ne baze te ketij ligji klasifikohen si te mbrojtura. Eshte Keshilli i Ministrave ai qe vendos perfundimisht se cilat zona do te klasifikohen si te mbrojtura dhe kategorite perkatese per shkallen e mbrojtjes. Siç percaktohet ne Strategjine Kombetare per Biodiversitetin, bazuar ne Ligjin per Zonat e Mbrojtura, Ministria e Mjedisit ka propozuar qe si Laguna e Nartes ashtu edhe Gadishulli i Karaburunit te konsiderohen zona te mbrojtura. Ne Strategjine Kombetare per Biodiversitetin propozohet qe Laguna e Nartes te klasifikohet ne kategorine V "pejzazh i mbrojtur" dhe delta e lumit Vjose ne kategorine IV " rezervat natyror i menaxhuar". Gjithashtu rekomandohet qe i gjithe Gadishulli i Karaburunit, nje siperfaqe prej 35,000 hektarësh ku perfshihen pyjet e Llogarase, ishulli i Sazanit, Malet e Rrezes se Kanalit, laguna e Orikumit dhe lugina e Dukatit, te klasifikohet ne kategorine II "park kombetar".

Nje iniciative e financuar nga PNUD i ka ofruar Ministrise se Mjedisit rekomandime per kufijte e propozuar te Lagunes se Nartes si "Zone e Mbrojtur", e cila eshte zona e mbrojtur me e afert me projektin. Ne kufijte e propozuar per klasifikimin e Lagunes se Nartes si zone e mbrojtur nuk perfshihet as territori Vlora B, as terminali i lendes djegese aty prane me tubacionet perkates.

Detajet e ligjit dhe zbatimi i tij jane akoma duke u perpunuar nga Ministria e Mjedisit. Me 8 Tetor 2002, Ministria e Mjedisit, pasi rishqyrtoi Draftin e Studimit te Zones pergatitur nga MWH, dha aprovimin paraprak per impiantin e prodhimit ne zonen Vlora B. Me tej, Ministria e Mjedisit nxiti Ministrine e Industrise dhe Energjitikes per te filluar sa me shpejt me procesin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis. Ministria e Mjedisit ne vijimesi ka siguruar te dhena per pergatitjen e VNM dhe siç eshte cituar me lart, ka rene dakort per zbatimin e rekomandimeve te Vleresimit perfundimtar te Ndikimit ne Mjedis.

4 Te dhena baze mbi kushtet e kantjerit

4.1 Vendndodhja e zones se mbrojtur

Figura A1 tregon vendndodhjen e kantjerit te propozuar dhe te zonave te mbrojtura qe e rrethojne. Ligji Shqiptar mbi zonat e mbrojtura eshte akoma ne zhvillim. Gjithsesi, ligji i propozuar do te percaktoje masat parandaluese qe duhet te merren per zhvillimin e zonave te mbrojtura. Ne Kapitullin 3 te VNM Perfundimtare jane diskutuar gjersisht keto lloj zhvillimesh. Ne VNM Perfundimtare eshte cituar qe Laguna e Nartes eshte propozuar te jete zone e mbrojtur. Kufijte e propozuar per Lagunen e Nartes nuk perfshijne zonen ku do ndertohet kantjeri i propozuar ose terminalin ekzitues te furnizimit me produkte nafte.

Figura A.1

Vendndodhja Relative e Zonave te Mbrojtura prane Kantjerit



Speciet me kritike qe perbejne shqetesim per zonen e Lagunes se Nartes dhe Gadishullin e Karaburunit jane tre specie te faunes qe jane listuar nga IUCN si te kercenuara ose te rrezikuara ne shkalle botrore (Lista e Kuqe 2000 e Specieve te Kercenuara). Keto specie jane: Pelikanin Dalmatian (*Pelecanus Crispus*), Sokoli i Vogel (*Falco Naumanni*), dhe Vidra e Rivieres Europiane (*Lutra Lutra*). Te treja keto specie jane te njohura per jetesen e tyre ne zonen e Lagunes se Nartes. Pelikanit Dalmatian gjendet ne Ballkan, zonen e mesme te Europes Lindore dhe ne Azi. Sokoli i Vogel gjendet ne Europen Perendimore, Afriken e Jugut dhe Azi. Ndersa Vidra e Rivieres Europiane gjendet ne kontinentin European dhe ate Aziatik dhe ne nje pjese te Afrikes.

Sic eshte cituar dhe ne VNM Perfundimtare, ndertimi ose operimi i impiantit te propozuar do te jete ne perputhje me normat ne fuqi dhe nuk do te kete ndikim negativ ne vegjetacionin e Lagunes se Nartes dhe ne ekosistem. Gjithashtu ndertimi ose operimi i impiantit te gjenerimit me cikël te kombinuar nuk do te kete ndikim ne speciet e lartepmendura.

Impianti i propozuar perdor teknologjine me te perparuar per kohen dhe lende djegese me permbajtje te ulet sqfuri duke zvogeluar sasine e ndotjes qe emetohet ne mjedis nga teknologjia e prodhimit te energjise termike e cila eshte me e mira ne krahasim me te tjerat, sic jane motorret me kollodok ose teknologjia e djegijes se qymyrit. Te gjitha ndikimet e cilesise se ajrit qe rezultojne gjate ndertimit dhe operimit te impiantit do te jene brenda standarteve nderkombetare per mbrojtijen e shendetit te njerezve, vegjetacionit dhe ekosistemit. Me me detaje, mos ndikimi nga emetimet ne ajer mbi Speciet e Kuqe te Listuara bazohet ne parashikimin mbi perqendrimet e SO₂ dhe NO_x, te cilat do te jene afersisht sa gjysma e normave te Bashkimit European.

Ndikimet ne Gjirin e Vlores nga pikepamja e cilesise se ujit do te jene pranueshme – shkarkimet termike dhe kimike do te jene ne perputhje me te gjitha standardet per efluentet. Niveli i klorit rezidual do te kete normen e shkarkimit nen 0.2 mg/l dhe shkarkimet termike do te kene nje rritje te temperatures me pak se 1 0C brenda nje zone me shumellojshmri prej 100 m (maksimumi 23 m nga dalja e difuzorit). Rritja e temperatures deri nen 3 0C lejohet nga standartet nderkombetare. Do te merren masa paraprake per te ndaluar shkarkimin e sedimenteve ose te shkarkimeve aksidentale te lendes djegese ne mjedis. Sic eshte permendur dhe me perpara, VNM Perfundimtare paraqet nje vleresim te koshtos se nevojshme per zbutje te ndikimeve.

5 Identifikimi i Impakteve dhe Masat Zbutese te Propozuar

5.1 Ndikimi nga Pikepamja Ekonomike

Ndikim ne kete zone nga pikepamja ekonomike mendohet te jete teresisht pozitiv. Forca punetore per ndertim do te jete me shume se 500 veta, efektet per para shtese ne ekonomin lokale do te jene domethenese per 2 vitet e periudhes se ndertimit. Edhe gjate fazes se operimit te impiantit do te verehet i njejti efekt pozitiv, ne objekt do te punesohen 40 njerz.

5.2 Vlerat kufi per dioksidin e sqfurit, oksidet e nitogjenit dhe korrigjimi i tabelave

Nje koment ne lidhje me mungesen e prezantimit te normave i referohet Tabeles 6.10 te VNM Perfundimtare. Vlerat kufi per dioksidin e sqfurit, SO₂, oksidet e nitrogjenit NO_x, dhe grimcat materiale PM jepen ne Direktiven e Komunitetit European EU 1999/30/EC.

Disa njesi qe nuk jane paraqitur ne Tabelen 6.7 dhe 6.8 te VNM Perfundimtare jane paraqitur ne menyre te sakte ne Tabelen A.3 dhe A.4 me poshte.

TABELA 6.7

PARAMETRAT E OXHAKUT TE TURBINES ME DJEGIE

Oxhaku	Kordinata X	Kordinata Y	Ngritja (m)	Lartesia (m)	Temp. (K)	Shpejtesia (m/s)	Diametri (m)
Oxhaku 1	157.5	-142.5	1.5	46.9	399.4	24.7	2.67
Oxhaku 2	187.5	-123	1.5	46.9	399.4	24.7	2.67

TABELA 6.8

PARAMETRAT E NDERTESES

Ndertesa	Kordinata X	Kordinata Y	Ngritja (m)	Lartesia (m)	Gjatesia (x)	Gjeresia (Y)	Rrezja (m)
Njesia 1 e Hyrjes Ajrit	97.5	-82.5	1.5	12	7.2	4.8	NA
Njesia 2 e Hyrjes Ajrit	153	-50	1.5	12	7.2	4.8	NA
Ndertesa e Sherbimit	81	-147	1.5	6	18	24	NA
Kanali 1 i Daljes	107.3	-176.4	1.5	5.5	7.2	14.4	NA
Kanali 2 i Daljes	147.4	-53.6	1.5	5.5	7.2	-14.4	NA
Kanali Bashkues 1	153.2	-50.1	1.5	9.5	7.2	-6.6	NA
Kanali Bashkues 2	101.7	-80	1.5	9.5	7.2	6.6	NA
Ndertesa e Turbines	49.5	-96	1.5	18.3	27	36.5	NA
Trajtimi Ujit	63.8	-118.9	1.5	6.1	15.2	18.4	NA
Sherbimi I Mbrojtjes kundra Zjarrit	52.5	-124.5	1.5	12.2	NA	NA	6.4

Ndertesa per Demineralizimin e Ujit	42	-112.5	1.5	12.2	NA	NA	7.2
Depozita 1 e Lendes Djegese	66	18	1.5	12.2	NA	NA	11.6

5.3 Shkarkimet ne uje

VNM Perfundimtare paraqet informacionin mbi shkarkimet e ujerave te ndotur nga impianti i propozuar. Shkarkimet e ujerave te ndotur do te jene ne perputhje me standartet e zbatueshme nderkombetare per llojet e shkarkimeve qe paraqiten ne VNM Perfundimtare. Tabela 3.4 dhe VNM perfundimtare paraqesin standartet e efluenteve te impiantit te gjenerimit termik. Tabela 6.15 permban udhezues te pergjithshem mbi shkarkimet sanitare. Kontraktuesi EPC do te jete pergjegjes per projektimin e sistemeve te trajtimit ne perputhje me standartet e efluenteve te listuara ne Tabelen 3.4. Kostot per keto pajisjet jane perfshire ne vleresimin e te gjithe kostove per impiantin dhe jane paraqitur ne Tabelen 8.1 dhe 8.2 shoqeruar me nje pershkrim te pajisjeve te nevojshme.


Do te jete pergjegjesi e kontraktuesit EPC te paraqese informacion me te detajuar mbi pozicionin e pajisjeve te cilat duhet te mbrohen nga nje ndares vaj-uje. Ne VNM Perfundimtare percaktohet qe ndaresi vaj-uje do te instalohet per te mbrojtur defektet qe mund te ndodhin gjate shkarkimit te ujerave te ndotur me vaj.

5.4 Shperndarja potenciale e merkurit nga aktiviteti i gerryerjes

Nuk gjenden te dhena te vlefshme ne lidhje me problemet qe sjellin sedimentet e merkurit ne afersi te zones se impiantit te propozuar te gjenerimit ne gjirin e Vlores. Gjithsesi, ndotja nga mercuri eshte dominuese ne PVC-ne dhe uzinen e braktisur te sodes, te lokalizuara afersisht 2 km ne jug te kantjerit. Objekti nuk funksionon qe ne vitin 1992 dhe per nje kohe te gjate nuk ka pasur burim aktiv te ndotjes. Informacioni me i vlefshem per perhapjen e merkurit dhe te sedimenteve te tjere ndotes, te metaleve te rende nga uzina, jepet per zonen me te afert qe shtrihet 700 m nga Gjiri i Vlores, afersisht 1,800 deri ne 2,000 m ne Jug te hyrjes se propozuar dhe 1,100 deri ne 2,000 m ne Jug te struktures se shkaterruar. Ky informacion jepet ne Tabelen 5.5 te VNM Perfundimtare. Ne Tabelen 5.5 te VNM perfundimtare dhe ne Figuren A2 te meposhtme paraqitet nje informacioni i permbledhur mbi perqendrimin e merkurit ne kete zone.

Figura A2

Informacioni mbi sedimentet e merkurit ne Gjirin e Vlores



Pergendrimet jane me te ulta ne veri te uzines se braktisur dhe me pas ato largohen nga zona Vlora B ku mendohet te ndertohet kantjeri i propozuar. Kjo ndodh per shkak te levizjes ne breg te sedimenteve duke vazhduar rrjedhjen per ne jug, larg nga kantjeri. Bazuar ne kete informacion, nuk eshte parashikuar qe ndonje material gerryes te permbaje perqendrimet e merkurit ose te metaleve te rende nga uzina e braktisur. Si mase praprake, eshte pergatitur plani zbutes gjate ndertimit i cili duhet te siguroje qe mostrat dhe analizat e sedimenteve nuk paraqesin nivel ndotje si dhe materialet e ndotur jane menaxhuar ne menyren e duhur.

Nje problem tjetër ne lidhje me zvogelimin e perdorimit te ujit te detit te ketij gjiri eshte varianti i kullave te ftohjes, i cili u sugjerua si mundesi per te zvogeluar gerryerjen e strukturese hyrjes dhe te shkarkimit te ujerave gjate fazes se ndertimit. Perdorimi i kullave se ftohjes do te zvogeloje afersisht 80 % sasine e hyrjes dhe shkarkimit te ujit. Gjithsesi, kerkesa per te zvogeluar sasine e ujit do te kerkoje ndertimin ne te njejtin vend te strukturese hyrjes dhe te shkarkimit te ujit, sic eshte planifikuar me pare ne sistemin ftohes. Do te kerkojohet qe te gerryhet sasi e njejte materialesh per cilindo variant te zgjedhur per ndertim; prandaj perdorimi i kullave te ftohjes nuk do te minimizojë perhapjen potenciale te ndotjes per shkak te gerryerjes.

Gjithashtu, nuk eshte marre parasysh gerryerja qe duhet ti behet terminalit ekzistues te furnizimit me nenprodukte nafte i cili do te furnizoje lende te pare impiantin. Fillimisht furnizimi i impiantit do te behet me barka, me madhesi me te vogel se anijet qe perdoren ne Portin e Vlores dhe ne terminal.

5.5 Shkarkimet e ujerave te ndotur

Si rrjedhoje e shkarkimeve te pastra nga ndaresi nafte-uje, do te kete nje numer te caktuar shkarkimesh nga centrali. Trajtimi i ujerave te ndotur sanitar do te behet nepermjet trajtimit sekondar aerobik dhe anaerobik ne impinatin e trajtimit te ujerave te ndotur. Nxehtesia e trajtuar nga gjeneratori si rrjedhoje e kondesimit te avullit do te rritet nga mbingarkesa. Rregullimi i pH do te behet nepermjet depozitave te neutralizimit. Ndersa lenda osmosis e kthyer do te shkarkohet nepermjet ujerave nga kullat e ftohjes. Nga procesi i shkripezimit prodhohet lenda osmosis e kthyer me permbajtje uje deti.

5.6 Rreziku natyrore

Kontraktuesi EPC do te jete pergjegjes per projektimin dhe ndertimin e centralit ne menyre te tille qe te zbusse rreziqet potencial qe mund te shkaktohen nga termetet ose stuhite. Ne VNM Perfundimtare gjendet informacion i mjaftueshem per identifikimin e detyrave te kontraktuesit EPC. Kerkesat jane perfshire dhe ne dokumentacionin e kontrates.

6. Identifikimi i vendeve

6.1 Variantet per zgjedhjen e kantjerit

Kapitulli 7 i VNM Perfundimtare si dhe Studimi Perfundimtar mbi Zgjedhjen e Vendit , pergatitur ne Tetor te 2002 paraqesin kushtet per perdorimin e vendit dhe procesin per zgjedhjen e teknologjise.

Kushtet per perdorim jane si me poshte:

- Rehabilitimi i mjedisit
- Problemet mbi cilesine e ajrit
- Kostoja per nivelim
- Problemet social-ekonomike
- Zvogelimi i humbjeve ne sistemin e transmetimit dhe permirsimi i tensionit
- Transmetim i sigurt dhe ne vazhdimesi

- Sigurimi i lendes djegese
- Kërkesa për ujë dhe kanalizimi i ujerave të ndotur
- Transporti
- Siguri në përdorimin e tokës

Me poshtë kemi një prezantim të Studimit Profundimtar mbi Zgjedhjen e Vendi, mënyrën e vlerësimit të teknologjive dhe të vendeve të ndryshme. Studimi paraqet vlerësimin hap pas hapi të mjedisit dhe informacionin e përmbledhur mbi rekomandimet për zhvillim për secilën zonë.

Zona 1 – Durres

Vendi i propozuar ndodhet në një zonë të gjelberuar, me topografi të sheshtë. Sot, përdorimi i tokës për prodhime bujqësore është ulur ndjeshëm. Në baze të vlerësimit profundimtar mbi zgjedhjen e zonës, duhet që fushat përreth të ngrihen 2 deri në 3 m për shkak të përmblytjeve që shkaktohen në këtë zonë.

Në juglindje të Kepit të Bishtit të Palles gjendet një depo e braktisur për grumbullimin e mbetjeve kimike të rrezikshme, rreth 10 km në veri të qendër të qytetit të Durresit dhe rreth 1 km nga vendi i zgjedhur. Objekti përfshin 3 ndërtesa të vecuara që përdoren për grumbullimin e rreth 700 ton kimikateve për prodhimin e HCH dhe mbetjeve të HCH. HCH është një pesticid i cili është i qëndrueshëm ndaj mjedisit. Depoja është mbushur gjatë viteve 1989 dhe 1990. Kohët e fundit, UNEP-i ka bërë investigime të detajuara në lidhje me vendin e zgjedhur dhe ka analizuar mënyrën për të zvogëluar rrezikshmerinë nga grumbullimet e mëparshme në këtë depo (pranë kësaj depo gjendet dhe një depo tjetër grumbullimi si dhe një vend grumbullimi 4 km në jug të kësaj zone). Pra ky vend është një "hot spot" që sjell rrezik të pashmangshëm për shëndetin e njerezve dhe mjedisin.

Në lidhje me vezhgimet e UNEP-it, tre ndërtesat janë të mbingarkuara me fuci celiku të korroduara, thasë të çare nga të cilat rrjedhin kimikate dhe ndërtesa me dyer dhe dritare të thyera. Toka përreth depos pritet të jetë e ndotur, megjithatë është kufizuar deri në 100-200 m në nivelin e depos kapaciteti transportues i ndotesve dhe i ndikimeve në ujërat nëntokësore. Vendi drenazhohet nga sistemi i thjeshtë i drenazhimit të qytetit të Durresit, i cili transporton ujin sipërfaqësor në zonën e përmblytur të stacionit të pompave në Porto Romano dhe me pas i shkarkon në ujërat e Detit Adriatik. Toka e ndotur përgjatë sistemit të drenazhimit mendohet të kufizojë kanalën deri në 10 m. Nuk mendohet të kemi ndotje të ujerave në thellësi.

Popullsia vendase është lokalizuar në një vendbainim të vogël 300 m nga depoja e braktisur, e cila krijon ndotje për zonën. Njerezit janë njoftuar vazhdimisht për të parandaluar përdorimin për ndërtim të materialeve të depos si dhe përdorimin e tokës pranë saj për kultivim dhe kullotje. Pranë zonës janë vezhguar femije që luajnë dhe përdorin për ushqim prodhimet bujqësore nga zona e ndotur.

Gjithashtu kanalizimet e ujerave sanitare dhe peshqit qe kapen nga peshkataret e zones mund te jene te ndotur. Deri tani nuk eshte paraqitur nje program i detajuar mbi mostrat dhe analizat qe caktojne kufirin e ndotjes nga vend grumbullimi i meparshem i kimikateve.

Studimi i Fisibilitetit mbi masat per zvogelimin e rrezikshmerise pergatitur nga UNEP (Qershor 2001) rekomandon ndalimin e menjehershem te futjes se kimikateve ne zonen e depos se braktisur dhe parandalon ndotjen e metejshme te ujerave sanitar ose te atyre per qellime buqsore. Raporti paraqet nje strategji pastrimi per largimin e mbetjeve kimike, rehabilitimin e tokes dhe ndikimet ne ujerat nentokesor.

Zona perreth vendit te zgjedhur nuk eshte shume e populluar dhe duhet te pergatiten procedura per zhvendosjen e atyre pak shtepi qe gjenden prane vendit. Per shkak te mungeses se receptoreve te ndjeshem ne zone, ndikimet nga zhurmat mendohet te mos sjellin shqetesim. Gjithsesi, prania e impiantit te gjenerimit do te sjelle shqetesime nga pikepamja vizuale per zonen e Gjirit te Lalezit derisa ne zone te vendosen te tjere impiante industriale.

Sic dihet, Durresi eshte qyteti i dyte me i madh industrial i Shqiperise dhe ka portin kryesor ne vend. Rritja e popullsise se Durresit eshte me e madhja ne 4 - 5 vitet e fundit dhe sot popullsia totale eshte afersisht 150,000 banore. Vendi me i populluar nga banuesit e rinj eshte zona kodrinore ndermjet qytetit dhe Porto Romanos. Popullsia e zones eshte rreth 30,000 banore. Kepi i Bisht Palles eshte me pak i populluar dhe perdoret ne menyre te kufizuar per qellime buqsore. Peshkimi eshte nje tjetër aktivitet i rendesishem per popullsine lokale ne zonen prane Porto Romanos.

Llojet kryesore te industrise ne Durres perfshijne makinerite, kimikatet, elektriket, mobiljet, plastika dhe goma. Qyteti prodhonte gjithashtu anije me tonazh te rende, trena, vere, konserva peshku dhe te tjera produkte te konsumueshme. Qendra kryesore e industrise ndodhet ne pjesen lindore te qytetit, ne lagjen Shkozet.

Zonat kryesore turistike te Durresit jane Palzhi i Durresit dhe Plazhi i Currilave. Sipas autoriteteve vendase, zona e Bishtit te Palles dhe e Gjirit te Lalzit konsiderohen si zona me prioritet te madh per zhvillimin e turizmit ne Shqiperine e mesme. Sipas raporteve te UNEP (2001), bizneset e reja ne zonen e Gjirit te Lalzit lidhen me ndertimin e restoranteve dhe te plazheve.

Rekomandime per Zhvillim

Nga pikepamja konstruktive, zona e Durresit eshte mjaft e pershtatshme, por infrastruktura ekzistuese nuk lejon te jete me e preferuara nder zonat e tjera. Ndertimi i impiantit te gjenerimit me lende djegese te distiluar ne kete zone do te kishte avantazhe vetem nese do te ishin zhvendosur depoziatat e grumbullimit naftes.

Infrastruktura (rruget e pa mirembajtura), prane vendit te ndotur dhe ne afersi te zones se mbrojtur nga pikepamja mjedisore (Gjiri i Lalezit) perbejne shqetesim per zhvillimin e metejshem te zones. N.q.s zona do te zhvillohej per turizem, atehere do te pengohej ndertimi i TEC-it.

Deri me sot, nuk jane caktuar rekomandime per zhvillimin e metejshme te zones.

Zona 2 – Elbasan

Mjedisi

Zona e propozuar ndodhet brenda uzines se metalurgjise, ne toke fushore, e cila rekomandohet per zhvillime te metejshme ose per shfrytezim te vendit n.q.s pastrohet nga strukturat ekzistuese. Nga pikepamja vizuale nuk ka ndikim te menjehershem qe mund te shkaktoje shqetesim ne lidhje me ndotjen e zones ose kerkesen per rehabilitimin e saj. Zona paraqet shenja te qendrimit te ujit por gjithsesi nuk mund te konsiderohet si zone kenetore.

Cilesia e ajrit ne Elbasan ndikohet shume nga uzina ekzistuese industriale, por ne vecanti nga ajo e shkrirjes se ferro-kromit dhe Uzina Metalurgjike Elbasan. Uzina e Ferro-Kromit ne Elbasan ndodhet ne fushen e Vidhasit, afersisht 5 km ne lindje te qytetit. Uzina e cila eshte ndertuar qe ne vitin 1989 eshte prone e Qeverise Shqiptare dhe shfrytezohet nga Darfo S. P. A., nje kompani italiane. Kapaciteti nominal i projektuar per shkrirje eshte 48,000 ton/vit dhe prodhimi vjetor gjate 10 viteve te fundit luhatet ndermjet 10,000 dhe 20,000 ton/vit.

Uzina e shkrirjes se ferro-kromit permban 3 lloj Furrash me Hark Elektrik prej 9,000 MW dhe secila me kapacitet nominal prej 16,000 ton. Ne perputhje me vezhgimet e Bankes Boterore ne 2001, uzina nuk perdor asnje kontroll apo ndonje teknologji per trajtimin e emetimeve dhe ndotesit e emetuar nga kjo uzine perbejne rrezik serioz per shendetin e njerezve dhe mjedisin. Furrat me Hark Elektrik jane burimi kryesor per emetimet materiale dhe organike ne ajer, gjithashtu nga trajtimi i lendes se pare dhe i produkteve prodhohen grimca materiale te cilat me pas clirohen ne ajer. Ne kete zone nuk jane te vlefshme te dhenat mbi cilesine e ajrit, megjithate perbersit tipik te gazeve te lengshem te ketij sistemi jane: CO, CO₂, lendet organike. Grimcat e pluhrit nga shkrirja e Ferro-kromit permbajne metale, sic jane alumin, kadiumi, kromi VI, hekuri, plumbi, zinku, nikeli dhe bakri.

Sipas Bankes Boterore, ne planet per te ardhmen duhet te percaktohen modifikime te ndryshme per proceset e shkrirjes, me qellim permirsimin e eficences dhe zvogelimin e emetimeve ne ajer. Modifikimet, te cilat perfshijne perdorimin e teknologjise me furra ose instalimet ne sistemin e perpunimit duhet te jene ne perputhje me standardet Europiane te emetimeve ne ajer si dhe me ato te Bankes Boterore (20 mg/m³) per nivelin e emetimeve qe shkaktohen gjate

procesit te shkrirjes. Modifikimet jane planifikuar per te zvogeluar shkarkimet e lengeta dhe per te permiresuar procedurat e menaxhimit te mbetjeve te ngurta. Zona perreth uzines metalurgjike eshte nje nga zonat me industrine me te rende ne Shqiperi. Ne afersi te zones industriale ne Elbasan nuk ndodhen zona te ndjeshme dhe nuk jane identifikuar zona te mbrojtura nga pikepamja mjedisore.

Rekomandime per Zhvillim

Infrastruktura ekzistuese ne uzinen metalurgjike paraqet nje variant te mire per instalimin e termocentralit, me perjashtim te veshtiresive ne furnizimin e lendes djegese. Tubacinet e gazit nuk mund te jene te pershtatshem ne te ardhmen. Sic eshte permendur dhe me perpara, kosto kapitale e impiantit te gjenerimit me lende djegije qymyr kerkon pergatitjen e nje projekti ne lidhje me koston e transportit te lendes djegese per ne kantjer. Cilesia e ajrit do te shkaktonte shqetesim ne kontrollin e mjedisit perreth zones dhe koston kapitale per centralin elektrik.

Derisa te jene zgjidhur problemet me transportin e lendes djegese, nuk rekomandohen zhvillime te metejshme per zonen.

Zona 3 – Fier

Mjedisi

Zona e propozuar ndodhet prapa TEC-it ekzistues, ne nje zone fushore. Shume njesi te braktisura per prodhimin e avullit nepermjet nxehtesise duhet te shkaterrohen si dhe duhet te zhvendosen disa linja transmetimi.

Zona e propozuar pozicionohet ne nje zone industriale, ku ndodhet termocentrali, rafineria per perpunimin e naftes, etj. Problemet ne lidhje me ndjeshmerine e zones do te jene minimale.

Ne afersi te Fierit, nuk jane identifikuar zona te mbrojtura nga pikepamja mjedisore.

Rekomandime per Zhvillim

Nga pikepamja e transmetimit, kjo zone eshte nje zgjidhje e shkelqyer per shkak te uljes se humbjeve ne sistemin e transmetimit. Infrastruktura ekzistuese e centralit ne Fier paraqet nje variant te mire per instalimin e termocentralit te ri, me perjashtim te veshtiresive ne furnizimin me lende djegese. Tubacionet e gazit nuk mund te perdoren ne te ardhmen. Kosto kapitale lidhur me koston per transportin e qymyrit dhe te gazit natyror kerkojne pergatitjen e varianteve te tjere.

Gjithsesi, kjo zone eshte percaktuar si e dyta per nga rendesia ne krahasim me zonat e tjera per ndertimin e impiantit te gjenerimit me cikel te kombinuar.

Zona 4 – Korca

Mjedisi

Zona e propozuar ndodhet prane impiantit ekzistues se gjenerimit ne nje zone fushore ku gjenden pajisje te braktisura dhe ndertesa te shkaterruara. Nuk mund te percaktohet mundesia per ndotjen e zones.

Zona e propozuar ndodhet ne zonen industriale te Korces, prane termocentralit te braktisur. Problemet ne lidhje me ndjeshmerine e zones jane minimale.

Ne afersi te zones nuk jane identifikuar zona te mbrojtura nga pikepamja mjedisore.

Rekomandime per Zhvillim

Korca eshte nje nder qytetet kryesore te Shqiperise dhe ne qofte se zbatohet Projekti "Prometeu" per gazin mund te importoje gaz nepermjet ketij tubacioni. Transporti i lendes djegese eshte mjaft i veshtire dhe me kosto te larte si per qymyrin edhe per naften. Problemet e transportit lidhen gjithashtu dhe me shperndarjen e pajisjeve kryesore.

Derisa kjo zone te importoje gaz natyror, nuk rekomandohen zhvillime te metejshme.

Zona 5 – Shengjini

Mjedisi

Sic eshte permendur dhe me perpara, vendodhja per kantjerin perfundimtar nuk eshte percaktuar per shkak te topografise se varferte zones. Kjo zone nuk paraqet probleme nga pikepamja mjedisore.

Rekomandime per Zhvillim

Per shkak te demtimeve ne rrjetin e transmetimit dhe mungeses se tokes se pershtatshme per kantjer, nuk rekomandohen zhvillime te metejshme per kete zone.

Zona 6 A – Vlora A

Mjedisi

Nje pjese e zones rrethohet nga uzina kimike e braktisur ne Vlore. Ndotjet dhe strukturat e braktisura shkaktojne problem te madh nga pikepamja vizuale dhe kerkeses per rehabilitimin e mjedisit.

Uzina kimike ka operuar qe nga 1978 deri ne 1992 dhe me pas u shkaterrua gjate traziarave civile ne 1997. Uzina e meparshme perfshinte ndertesën e elektrolizes, njesine e prodhimit te monomerit te klor vinilit dhe njesine e prodhimit te poli klorivinilit. Uzina eshte burimi kryesor i perhapjes se ndotjes me merkur dhe mbetje kimike. UNEP ka pergatitur investigime te hollesishme per zonen, analiza per uljen e rrezikshmerise si dhe e ka percaktuar zonen si nje "hot spot" qe perben rrezik per shendetin e njerezve dhe mjedisin.

Sipas UNEP, ish uzina kimike perdorte sasi te medha te merkurit gjate procesit te elektrolizes dhe largonte materialet e ndotur me merkur ne vend depozitimit ndermjet uzines dhe Detit Adriatik. Gjate periudhes se funksionimit jane raportuar si te humbur rreth 65 ton merkur. Uzina eshte ndertuar pa asnje mase per kontrollin e ujerave te ndotur te cilet shkarkoheshin direkt pa u trajtuar ne Gjirin e Vlores. Mostrat dhe analizat e kryera ne 1998 tregojne qe merkuri metalik (Hg) dhe diklormerkuri (HgCl₂) jane ndotesit e pranishem ne kete zone. Sot, uzina eshte shkaterruar dhe nuk permban materiale te rishfrytezueshme per ndertim sic jane tullat, dyert, dritaret, metalet dhe pajisjet. Qeveria Shqiptare eshte perpjekur vazhdimisht nepermjet njoftimeve qe te ndaloje banimin e njerezve ne kete zone, gjithashtu UNEP ka raportuar qe nje pjese e materialeve te ndertimit te marra nga objektet jane riperdorur per ndertimin e shtepive brenda dhe jashte uzines. Rreth kesaj zone jetojne afersisht 180 familje dhe jane vezhguar femije qe luajne ne zonen e ndotur. Ne kete zone eshte vene re kullosja e kafsheve shtepiake dhe rritja e vegjetacionit.

Qeveria furnizon me uje te pijeshem familjet qe jetojne ne zonen e ish uzines, ndersa nga pusët sigurohet uji per kafshet shtepiake dhe vaditje. Thellesia e ujerave nentokesor ne uzine varijon ndermjet 1.0 dhe 1.7 m nen nivelin e tokes (mbgl). Drejtimi kryesor i rrjedhjes se ujerave nentokesor eshte ne perendim drejt Detit Adriatik, por ne lindje te zones verehen te tjera rrjedhje nga 200 deri ne 300 m. Zona karakterizohet nga pershkueshmeri e larte gjeologjike e cila lehteson transportin e ujerave te ndotur nentokesor ne drejtim te Detit Adriatik. Persa i perket popullsisë lokale dhe turistëve te cilet frekuentojne plazhin e Vlores gjate muajve te veres, jane ne rrezik ndaj ekspozimit me ujin e ndotur te detit ne Gjirin e Vlores.

Studimi i Fizibilitetit pergatitur nga UNEP (Qershor 2001) rekomandon zhvendosjen e menjehershme te familjeve qe jetojne brenda uzines dhe rreth zones se ndotur si mase parandaluese per uljen e rrezikut. Raporti thekson domosdoshmerin e pergatitjes se nje strategjie pastrimi per largimin e ndotjeve kimike duke i mbajtur te izoluara dhe te mbuluara si dhe eliminimin e tokes se

ndotur sa me larg zones. Zhvendosja e ndotjes sa me larg dhe krijimi i nje landfill-i te pershtatshem eshte vleresuar me nje kosto shtese prej 15 milion\$.

Zona 6 A ndodhet rreth 4 km larg nga qendra e Qytetit te Vlores. Vlora eshte nje qytet industrial, nje qender kulture dhe vend turistik si dhe ka portin e dyte me te madh ne Shqiperi. Popullsia e saj eshte rreth 120,000 banore. Industrite e vendosura ne Vlore perfshijne ate ushqimore, te materialeve per ndertim, te kimikateve dhe te prodhimit te qelqit. Objektet arsimore jane: Universiteti i Vlores, Shkolla e Marines dhe e Aviacionit. Ne Vlore ndodhen muzeume te ndryshme si dhe shume hotele dhe zona turistike te vendosur pergjate plazhit.

Zona e Lagunes se Nartes ndoshet rreth 4 km ne veriperendim te Vlores dhe rreth 2.5 km ne veri te zones 6 A. Laguna ze nje siperfaqje prej 10,000 ha dhe eshte e rrethuar me pyje, keneta, duna rere, plazhe dhe toke buqsore. Vete laguna e Nartes eshte rreth 42 km² me thellesi 0,5-1,2 m. Sipas studimeve te GEF, Laguna e Nartes po peson degradim te shpejte sepse ka filluar te ulet depertimi i ujerave detar dhe te pijshem si rezultat i sedimenteve ne kanalet qe lejojne kontaktin e lagunes me detin. Zona ka rendesi te madhe nga pikepamja ekologjike sepse ajo permban shumellojshmeri habitatesh dhe nje numer te madh speciesh te kercenuara. Zona nuk eshte e mbrojtur nga legjislacioni Shqiptare, por Strategjia Kombetare per Biodiversitetin (NSB) ka propozuar qe laguna te kthehet ne Zone te Mbrojtur (Kategoria V) ne zbatim te Ligjit Shqiptar per Zonat e Mbrojtura qe pritet te miratohet.

Parku Kombetar i Llogarase, Gadishulli i Karaburunit, Ishulli i Sazanit, Laguna e Orikumit, Fshati Dukat, etj. qe ndodhen ne zonen Jug-perendimore jane shpallur zona te mbrojtura nga pikepamja mjedisore.

Rekomandime per Zhvillim

Per shkak te ndotjes se madhe te tokes ne Zonen 6 A, kerkeses per rehabilitimin e mjedisit dhe problemit te furnizimit me lende djegese eshte preferuar si me e pershtashme se Zona 6 A, Zona 6 B.

Zona 6 B – Vlora B

Mjedisi

Zona 6 B ndodhet rreth 6 km ne veri perendim te Portit te Vlores. Sic eshte permendur dhe me pare, popullsia e saj eshte rreth 120,000 banore. Vlora eshte nje qytet industrial, nje qender kulture dhe vend turistik si dhe ka portin e dyte me te madh ne Shqiperi. Per informacion me te zgjeruar referoju diskutimit mbi Zonen 6 A. Ndotja e tokes ose kerkesa per rehabilitim e kesaj zone nuk shkakton problem nga pikepamja vizuale nga ndikimi.

Prane Vlores nuk jane identifikuar zona te mrojtura nga pikepamja mjedisore. Laguna e Nartes ndodhet rreth 1 km ne Veri te Zones 6 B. Kjo Lagune perfshin 10,000 ha dhe rrethohet nga pyje, keneta, duna rere, plazhe dhe toke bujqesore. Vete laguna e Nartes eshte rreth 42 km² me thellesi 0.5 -1.2 m. Sipas studimeve te GEF, Laguna e Nartes po peson degradim te shpejte sepse ka filluar te ulet depertimi i ujerave detar dhe te pijshem si rezultat i sedimenteve ne kanalet qe lejojne kontaktin e lagunes me detin. Zona ka rendesi te madhe nga pikepamja ekologjike sepse ajo permban shumellojshmeri habitatesh dhe nje numer te madh speciesh te kercenuara. Zona nuk eshte e mbrojtur nga legjislacioni Shqiptare, por Strategjia Kombetare per Biodiversitetin (NSB) ka propozuar qe laguna te behet Zone e Mbrojtur (Kategoria V) ne zbatim te Ligjit Shqiptar per Zonat e Mbrojtura qe pritet te miratohet.

Parku Kombetar i Llogarase, Gadishulli i Karaburunit, Ishulli i Sazanit, Laguna e Orikumit, Fshati Dukat, etj. qe ndodhen ne zonen Jug-perendimore jane shpallur zona te mbrojtura nga pikepamja mjedisore.

Rekomandime per Zhvillim

Zona 6 B ndodhet prane terminalit ekzistuese te furnizimit me lende djegese dhe relievi i saj fushor do te minimizojte kostot per pergatitjen e terrenit te pershtatshem per kantjerin. Nga pikepamja e transmetimit, instalimi i impiantit te gjenerimit do te permirsoje ne menyre te ndjeshme te gjitha humbjet ne sistem. Zona e Lagunes se Nartes perben problem per te ardhmen. Per momentin, Laguna nuk eshte nje zone e mbrojtur por ne ligjin qe do te aprovohet eshte propozuar mbrojtja e saj. Gjithsesi, ne nuk besojme qe Laguna e Nartes perben shqetesim te madh per mjedisin.

Zona 6 B eshte cilesuar si zona me e pershtatshme ne krahasim me zonat e tjera te propozuara. Pas Studimit te Fizibilitetit rekomandohet te behen vlersime te metejshme mbi ndertimin e centralit elektrik me cikel te kombinuar ne kete zone.

Edhe Ministria e Mjedisit ne Shqiperi eshte dakort per ndertimin e nje termocentrali te ri ne zonen Vlora B, si zona me e pershtatshme.

Studimi i Fizibilitetit dhe VNM Perfundimtar rikonfirmojne qe zona Vlore B eshte varianti me i mire nga pikepamja teknike, ekonomike, financiare dhe mjedisore per ndertimin e termocentralit.

6.2 Vlersimi mbi Kullat e Ftohjes

Nuk ka legjislacion qe te kufizojte perdorimin e kullave te ftohjes per centralet sic eshte dhe varianti i propozuar per TEC-in ne Vlore. VNM Perfundimtare paraqet nje nivel te pritshem te ndikimit ne mjedis qe shkaktohet nga mos perdorimi i perhershem i kullave te ftohjes. Sipas udhezuesve nderkombetar temperatura e lejuar e ngrohjes do te jete nen 3 0C ndersa shkarkimet kimike do te jene ne perputhje me normat e shkarkimeve per klorin rezidual. Kontraktuesi EPC duhet te paraqese nje studim mbi zonen, per te percaktuar ne menyre korrekte vendndodhjen dhe kohen me te mire per ndertimin e strukturave te hyrjes dhe te shkarkimit. Gjithashtu ai duhet te paraqese nje model te miratuar mbi perdorimin e centralit termik dhe te pershtase projektin e propozuar per shkarkimet nqs eshte e nevojshme. Kjo kerkese do te theksohet dhe ne dokumnetat e kontrates EPC.

Studimi Perfundimtar per Kantjerin dhe Studimi Perfundimtar i Fizibilitetit, prezantuar ne Tetor te 2002, paraqesin informacion mbi variantet per sistemin e ftohjes per centralin e propozuar. Nga keto studime nxjerrim perfundimin se zonat bregdetare ku uji i detit mund te shfrytezohet ne sistemin ftohes perbejne variantin me koston me efektive si dhe paraqesin variantin me te mire per temperaturen me te ulet te ujit ftohes. Kapitulli 7 i VNM Perfundimtare paraqet nje reference te studimeve te meparshme.

Si pjese e procesit te studimit te fizibilitetit, varianti i kullave se ftohjes eshte diskutuar edhe me Banken Boterore. Per projektin mund te jene te vlefshme dy tipe kulla ftohjesh te cilat me pas jane analizuar. Keto tipe jane: kulla ftohje me uje te pijshem dhe kulla ftohje me uje deti.

Kulla e ftohjes me uje te pijshem – Nje kulle ftohje me uje te pijshem do te kerkonte nje kosto prej rreth 3 milion \$. Ne varesi te permasave te centralit te zgjedhura sasia e kerkuar per uje do te jete 800 deri ne 1,200 gpm. Per shkak te furnizimit me nderprerje te ujit, ne Vlore, varianti i propozuar nuk konsiderohet si varianti qe mund te zbatohet.

